REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. ____prot., Tiranë ____.____.2026

V E N D I M

Nr. 30, datë 06.11.2026

"MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT "PLANI I PËRDORIMIT TË RADIOFREKUENCAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	**Gentian Sala**	**Kryetar**
Znj.	**Edlira Dvorani**	**Anëtar**
Z.	**Armer Juka**	**Anëtar**
Z.	**Bleron Dokle**	**Anëtar**
Znj.	**Diana Dervishi**	**Anëtar**

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 06 nëntor 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)" miratuar me vendimin nr.11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Drejtorisë së Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme, shqyrtoi, çështjen me objekt si më poshtë:

- *Miratimin për këshillim publik të Planit të Përdorimit të Radiofrekuencave në Republikën e Shqipërisë.*

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja “d”, pika 1 e nenit 12, nenin 63 të ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 13.12.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”;
3. Rregullore “Për procedurat e këshillimit publik”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 21, datë 07.12.2021,

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

1. Dokumenti për miratim për këshillim publik “Plani i Përdorimit të Radiofrekuencave”;
2. Relacioni shoqërues i projektvendimit;
3. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar,

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Spektri i radiofrekuencave është një burim natyror i kufizuar dhe një e mirë publike me vlerë sociale, kulturore dhe ekonomike. Administrimi i tij duhet të sigurojë përdorimin e frytshëm dhe efektiv për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, në përputhje me objektivat e ligjit dhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.
2. Neni 63, pika 1, i ligjit nr. 54/2024 ngarkon AKEP, me hartimin e planit për përdorimin e radiofrekuencave të disponueshme për përdorim. Sipas pikës 2 të këtij neni, Plani përgatitet në përputhje me përcaktimet dhe udhëzimet e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe përcakton nënbrezat për shërbime të ndryshme të radiokomunikimeve, duke marrë parasysh parametrat dhe kushtet teknike të përdorimit.
3. Këshilli i Ministrave, me VKM nr. 756, datë 13.12.2024, ka miratuar Planin Kombëtar të Frekuencave, i cili përbën dokumentin kombëtar të alokimit të brezave dhe përcaktimit të shërbimeve përkatëse. Plani i Përdorimit të Frekuencave konkretizon këto përcaktime në nivelin e nënbrezave, kanaleve dhe kushteve teknike, pa ndryshuar alokimet e miratuara nga Këshilli i Ministrave.
4. Dokumenti i paraqitur për konsultim publik “Plani i Përdorimit të Radiofrekuencave”, përmban kushtet e përgjithshme të caktimit dhe përdorimit të radiofrekuencave, planet e përdorimit për shërbimin fiks, brezat IMT, brezat deri në 1 GHz, lidhjet satelitore, rekomandimet dhe vendimet për përdorime të harmonizuara, si dhe shtojcat përkatëse.
5. Plani është përgatitur duke marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 54/2024, Planin Kombëtar të Frekuencave të miratuar me VKM nr. 756/2024, Radio Rregulloret e ITU-

së, rekomandimet e ITU-së dhe CEPT-it, aktet përkatëse të Komisionit Evropian dhe standardet e ETSI-t.

6. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 dhe në Rregulloren "Për procedurat e këshillimit publik", miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 21, datë 07.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi do të bëhet objekt i këshillimit publik, me qëllim marrjen e mendimeve, komenteve dhe sugjerimeve nga sipërmarrësit, përdoruesit dhe palët e tjera të interesuara,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë për këshillim publik dokumentin "Plani i Përdorimit të Radiofrekuencave në Republikën e Shqipërisë", sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Procedura e konsultimit publik do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit, sipas pikës 3 të këtij vendimi.
3. Ky vendim dhe dokumenti për konsultim publik: Plani i Përdorimit të Radiofrekuencave në Republikën e Shqipërisë, publikohen në faqen zyrtare të AKEP, www.akep.al.
4. Ngarkohet administrata e AKEP, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	**Edlira Dvorani**	**Armer Juka**	**Bleron Dokle**	**Diana Dervishi**